



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN




| | |
|--------------|--|
| DATE/A: | 25.01.2023 |
| PËR/ZA/TO: | Kryetarin e Komunës,z.Bashkim Ramosaj |
| NGA/OD/FROM: | Agnesa Vokshi-Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |



PLANI I PUNËS-2023

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale


- Përmbajtja e planit të punës
- 1.Misioni i Planit të Punës
- 2.Qellimi i Planit të Punës
- 3.Objektivat e Planit të Punës
- 4.Plani i aktiviteteve 2023




Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2023 planifikon rritjen e kapaciteteve te kuadrove mjekësore,zbatimin e projekteve te hartuara gjatë planifikimit me qëllim te rritjes së Mirëqenies Sociale ne Komunën e Deçanit ,dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale.


Misioni i Planit të Punës

- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka për mision krijimin e mundësive për ofrim sa më efikas të nevojave të qytetarëve të Komunës së Deçanit.
- Drejtoria është përgjegjëse për :






QELLIMI I PLANIT TË PUNËS:



Objektivat e përgjithshme të DSHMS:

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është organ i Komunës dhe funksionin e vet e ushtron duke u bazuar në:



OBJEKTIVAT:

| |
|--|
| <input type="radio"/> Ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit të qytetarëve. |
| <input type="radio"/> Parandalimi i sëmundjeve. |
| <input type="radio"/> Trajtimi mjekësor. |
| <input type="radio"/> Diagnostifikimi i hershëm i sëmundjeve. |
| <input type="radio"/> Përkujdesja ndaj të sëmurëve. |
| <input type="radio"/> Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. |
| <input type="radio"/> Referimi i pacientëve në nivelin dytësor. |


| |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Përgatitje të dokumentacionit për pacientët që kanë nevojë për trajtim dhe shërim jashtë qendrës klinike universitare, sipas rekomandimeve të komisioneve mjekësore. Realizimi i këtij objekti bëhet përmes rrjetit të organizuar të kujdesit parësor shëndetësor (KPSH), dhe është përgjegjësi e komunës që të menaxhojë këtë sektor përmes drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Sa i përket përgatitjes së dokumentacionit – plotësimit të formularit për trajtim dhe shërim jashtë qendrës klinike universitare, ky shërbim kryhet me kërkesën e qytetarëve të komunës sonë dhe palët në drejtorinë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale janë të obliguar që të paraqesin raportin e mjekëve me të cilin udhëzohet që të kërkojë trajtim dhe shërim jashtë QKUK-së. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Kujdes permanent për pacientët me çrregullime mendore, sigurimi i terapisë adekuate për këtë kategori si dhe përkujdesja nga Neuropsikiatri. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, mbahet evidencë e veçantë për pacientët e kësaj kategorie dhe për çdo muaj u sigurohet terapia e nevojshme. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Implementim i plotë i Strategjisë për parandalimin dhe luftimin e epidemive dhe pandemive. Realizimi i këtij objekti për vitin 2023-të, do të bëhet në koordinim të plotë me nivelin qendror gjegjësisht me Këshillin ndërministror. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shëndetësore, blerjen e aparaturës mjekësore të nevojshme dhe të paraparë me buxhetin e komunës. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë sa i përket furnizimit me barna nga lista esenciale, si dhe bashkëpunim me institucione tjera që ofrojnë shërbime shëndetësore, bashkëpunim me donatorët e ndryshëm, organizatat qeveritare dhe joqeveritare etj. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Planifikimi i realizimit të projektit të vizitave sistematike të nxënësve të klasave të para, pesta dhe nënta, me qëllim të zbulimit të hershëm të sëmundjeve të kariesit dhe sëmundjeve tjera si dhe promovim shëndetësor tek të rinjtë me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse. Ky objektivi do të realizohet gjatë vitit 2023 duke u koordinuar me Drejtorinë e Arsimit ndërsa implementimi i këtij projekti do të bëhet nga profesionistët shëndetësor të QKMF-së, në Deçan. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Organizimi dhe përcjellja e vazhdueshme e transportit për pacientët me regjim dialize, kujdesi ndaj personave me regjim shtrati etj. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Menaxhimi i kontratave për barna që nuk janë në listën esenciale, për pajisje mjekësore, inventar, material shpenzues etj. |

| |
|---|
| <ul style="list-style-type: none"> ○ SISH(sistemi i informimit shëndetësor)ne QKMF funksionon në menyrë adekuate.Për të qenë përfituese nga fondi i cili është siguruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Banka botërore, ne jemi të obliguar që ti raportojmë vizitat shëndetësore që kryhen në QKMF, QMF dhe AMF. Dhe për këtë është i nevojshëm urgjentisht që të fillohet me implementimin e SISH – it, edhe ne QMF dhe AMF . |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Kujdesi ndaj kategorive të dalura nga lufta e UÇK-së, invalidëve civil të luftës si dhe kujdesi ndaj të punësuarve në botën e jashtme rreth dokumentacionit të tyre. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Përgatitjet rreth implementimit të ligjit për sigurime shëndetësore në rast të aplikimit të këtij ligji. Në momentin kur ky ligj të hyjë në fuqi, pjesa që u takon komunave e në këtë rast drejtorisë për shëndetësi do të realizohet nga stafi i drejtorisë. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Përkujdesje ndaj personave me nevoja te veçanta. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Përkujdesje për pensionistët ne forma te ndryshme ,qoftë shëndetësore apo sociale. |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunim dhe përkrahje ndaj OJQ-ve qe ndërlidhen më mirëqenie sociale . |
| <ul style="list-style-type: none"> ○ Ofrimi i shërbimeve sociale ne mënyre te barabartë për të gjithë qytetarët me nevojë ,përmes organit të kujdestarisë. |

AKTIVITETET :



- Këshillimorja në QKMF që i informon pacientët rreth rreziqeve te semundjeve të ndryshme
- Bashkëpunimi më KFOR-in Italian,për ndihmë shëndetësore
- Projektet me AQH



INVESTIMET KAPITALE PËR VITIN 2023

| 2023 | 2023 | 2023 | Në përfundim | Në përfundim | 2023 |
|-------------------|---|-----------------------------|---|------------------------------------|------------------------|
| Pajisje Mjekësore | Renovimi i objektit të Qendrës për Punë Sociale | Renovim i toaleteve ne QKMF | Ndertimi i Objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Strelc | Pajisja me inventar ne QMF dhe AMF | Renovim i AMF-Lumbardh |